



Funded by the
European Union

Regional Programme on Local Democracy in the Western Balkans 2 ReLOaD2



PYETJE TË SHPESHTA MBI THIRRJEN PUBLIKE PËR PROJEKT PROPOZIME NGA ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE PËR RININË TË HAPURA NË GJASHTË BASHKI PARTNERE TË PROJEKTIT RELOAD2 NË SHQIPËRI: KAMËZ, KAVAJË, KUKËS, LUSHNJË, PATOS DHE SARANDË

A është thirrja e hapur vetëm për organizata që janë regjistruar dhe kanë veprimtari në gjashtë bashkitë partnere? A ka një diferencim në vlerësimin e tyre?

Thirrja është e hapur dhe e barabartë për të gjitha OShC-të që janë zyrtarisht të regjistruara dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në Shqipëri dhe kërkesat e thirrjes. Të gjitha projekt propozimet do të vlerësohen në përputhje me Tabelën e vlerësimit të publikuar në Udhëzuesin për Aplikantët (Shtojca 6).

A mund të jetë zbatimi i një projekti në kuadër të thirrjes përtej territorit të bashkisë ku është hapur thirrja?

Projektet duhet të parashikojnë aktivitete, grupe të synuara dhe të zbatohen ekskluzivisht në territorin e Bashkisë në thirrjen e së cilës po aplikojnë.

A mund të bëhet kombinimi i dy ose më shumë prioriteteve në një projekt propozim?

Projekti duhet të trajtojë të paktën njëren prej prioriteteve të thirrjes. Trajtimi i dy ose më shumë prioriteteve të thirrjes është njësoj i vlefshëm.

Në cilën gjuhë duhet të plotësohet dokumentacioni i aplikimit?

Gjuha e thirrjes është gjuha Shqipe.

Sa mund të jetë buxheti për një projekt?

Buxheti për një projekt mund të jetë minimumi 700,000 Lekë dhe maksimumi 2,000,000 Lekë.

Cili është numri i kopjeve të dokumentacionit që duhet dorëzuar nga organizata partnere?

Organizata partnere, njësoj si organizata lider duhet të dorëzojë dokumentacionin e plotë në tre kopje fizike dhe një kopje elektronike (USB).



Funded by the
European Union

Regional Programme on Local Democracy in the Western Balkans 2 ReLOaD2



Sa projekt propozime mund të paraqesi një organizatë për thirrjen? A ka penalizim nëse një organizatë aplikon në thirrje me nje projekt si organizatë lider dhe një projekt si organizatë partnere?

Organizata (e vetme ose në partneritet) mund të paraqesi më shumë se një projekt propozim. Kushte të thirrjes nuk parashikojnë penalizim për paraqitjen e më shumë se një aplikimi (si në cilësinë e aplikantit kryesor ashtu dhe në cilësinë e partnerit). Aplikantët duhet të mbajnë në konsideratë se shuma e projekt propozimeve të dorëzuara në të gjitha cilësitë dhe thirrjet nuk duhet të tejkalojë shumën 7,000,000 Lekë.

A mund të aplikojë në thirrje një organizatë që është duke zbatuar projekt në kuadër të thirrjes së parë të ReLOaD2?

Po. Thirrja është e hapur dhe për organizatat që janë duke zbatuar projekt propozime. Organizata duhet të demostrojë kapacitetet për të menaxhuar me shumë se një projekt në të njëjtën kohë.

Nëse një organizatë e themeluar në muajt e fundit dhe që nuk ka ende projekte në implementim, por ka të angazhuar një staf me eksperiencë disa vjeçare, a përjashtohet nga mundësia për të aplikuar në thirrje?

Thirrja është e hapur për aplikim për të gjitha organizatat me kufizimet e parashikuara në udhëzuesin për aplikantët (shtojca 6 e thirrjes). Organizatat e reja mund të aplikojnë në thirrje por paraprakisht këshillohen të vetëvlerësojnë plotësimin e kërkesave të thirrjes për kapacitetet financiare dhe operative. Nëse vetë organizata nuk i plotëson të gjithë kriteret, aplikimi me një organizatë partnere që i plotëson këto kriteret është i këshilluar.

Cilat janë kriteret që duhet të plotësojë një subjekt për të qënë partner në projekt?

Partnerë në projekt mund të jenë organizata të tjera të shoqërisë civile, që plotësojnë kërkesat e thirrjes për aplikantët. Partnerët marrin pjesë në planifikimin dhe zbatimin e projektit, duke patur të njëjtat rregulla për shpenzimet sikurse dhe organizata lider. Partneri dhe organizata lider, si pjesë e paketës së aplikimit duhet të kenë të plotësuar dhe përfshirë dhe Deklaratën e partneritetit (Shtojca A).

A do të ketë bashkëfinancim nga organizatat?

Jo. Kushtet e thirrjes nuk kërkojnë bashkëfinancim nga organizatat zbatuese të projektit.



Funded by the
European Union

Regional Programme on Local Democracy in the Western Balkans 2 ReLOaD2



Cili është dokumentacioni i kërkuar për organizatën partnere?

Organizata partnere, ashtu si dhe organizata lider duhet të dorëzojë:

- Vendimi i regjistrimit të organizatës në Gjykatë dhe ndryshime të tij nëse ka patur.
- Kopja e statutit të organizatës,
- Formulari i kompletuar identifikues administrativ (Shtojca 11),
- Formulari i kompletuar identifikues Financiar (Shtojca 12),
- Deklarata e plotësimit të kriterëve e plotësuar dhe e nënshkruar (Shtojca 13),
- Kopje e Pasqyrave financiare të OSHC-së (a. bilanci; b. PASH; c. cash flow; ç. shënimet shpjeguese) për vitin paraardhës e firmosur nga një kontabilist i miratuar ose financieri i OSHC-së sipas kriterëve në fuqi, përveç rasteve nëse organizata është themeluar gjatë këtij viti.
- Një raport përshkruar i projekteve dhe aktiviteteve të OSHC për vitin paraardhës, përveç rasteve nëse organizata është themeluar gjatë këtij viti.
- Deklarata e shmangies së konfliktit të interesit (shtojca B), nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor, anëtarët e bordit si dhe personat e parashikuar për tu përfshirë në zbatimin e projektit.

Deklarata e partneritetit (shtojca A) është një dokument shtesë që plotësohet nga organizatat aplikuese (lider dhe partner).

Çfarë duhet të përfshijnë pasqyrat financiare të dorëzuara nga aplikanti?

Pasqyrat financiare të vitit paraardhës (2021) duhet të jenë të plota dhe të përfshijnë bilancin, pasqyrën e të ardhura-shpenzimeve, cash-flow, shënimet shpjeguese dhe të jenë të firmosura nga kontabilisti i miratuar ose financieri i OShC-se sipas kriterëve në fuqi. Përfshirë nga dorëzimi i pasqyrave financiare bëjnë organizatat që janë themeluar gjatë vitit 2022.

Çfarë konsiderohet konflikt interesi në kuadër të thirrjes/ve?

Organizatat që janë subjekt i konfliktit të interesit sipas parashikimeve në dispozitat e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” do të përjashtohen nga pjesëmarrja në thirrje. Gjithashtu, përjashtohen nga vlerësimi ato projekte, në të cilat: Drejtori ekzekutiv, anëtarët e bordit apo personat e planifikuar për t’u përfshirë në projekt, si dhe personat e lidhur me ta sipas legjislacionit në fuqi, janë të punësuar në bashkinë apo institucionet e saj të vartësisë në të cilën aplikohet, në pozicionet: Zyrtari i nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues sipas legjislacionit të shërbimit civil si dhe anëtar i Këshillit Bashkiak, anëtar i kabinetit të Kryetarit të Bashkisë. Për qëllim të kësaj thirrje, palë e lidhur janë: bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e drejtorit ekzekutiv/anëtarit të bordit/personave të parashikuar për t’u përfshirë në projekt, e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.